



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 18
Prishtinë, më 16 qershor 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 16 QERSHOR 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmuan **Xhavit HALITI** dhe **Sabri HAMITI**, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 77 deputetë. Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Ratifikimi i Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për persona të zhdukur,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndihmën shtetërore,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nisma legjislative,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për akreditim,

9. Shqyrtimi i Propozim-kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, për vitin 2012-2014,
10. Shqyrtimi i Projekt-Planit hapësinor të Kosovës, për periudhën 2011-2020,
11. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, për vitin 2010,
12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, për vitin 2010,
13. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës,
14. Emërimi i një anëtari të Komisionit Shqyrtues në Zyrën e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Ardian Gjini, Ganimete Musliu, Sabri Hamiti, Alma Lama, Haki Demolli, Goran Marinković, Bekim Haxhiu, Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, ministri Bedri Hamza, zv.kryeministrja Edita Tahiri, dhe kryetari Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti, Arsim Bajrami parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja, në lidhje me përgatitjet rreth fillimit të ndërtimit të ndërtimit të objektit të ri të Fakultetit Juridik të UP-së.

Ministri Buja iu përgjigj pyetjes së deputetit Bajrami.

Deputetja Time Kadrijaj parashtoi pyetje për ministrin Nenad Rashiç në lidhje me respektimin e Ligjit të Punës në vend, respektivisht nenit 49 i këtij ligji.

Ministri Rashiç iu përgjigj pyetjes së deputetes Kadrijaj.

Deputetja Time Kadrijaj parashtoi pyetje për ministrin Mahir Yagcillar në lidhje me mos harmonizimin e Ligjit të Punës me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ministri Yagcillar iu përgjigj pyetjes së deputetes Kadrijaj.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjeve plenare të mbajtura me 31 maj dhe 3 qershor 2011

Kuvendi miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të datës 31 maj dhe 3 qershor 2011, pa vërejtje.

Deputeti Halit Krasniqi pati vërejtje në Transkript, ngase nuk ishte evidencuar diskutimi i tij lidhur me Propozim-rekomandimin për Tribunalin e Hagës. Transkripti është korrigjuar sipas kërkesës së tij.

4. Ratifikimi i Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor

Kryetari ftoi Ministrin e Financave për prezantimin dhe arsyetimin e Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor.

Ministri **Bedri Hamza**, në fillim të fjalës së tij, tha se Ministria e Financave ka filluar procedurën për anëtarësimin e Doganës së Republikës së Kosovës në Organizatën Botërore të Doganave, me seli në Bruksel.

Ky anëtarësim përveç përfitimeve që do të ketë Dogana e Kosovës, ajo pritet ti ketë edhe disa detyrime të cilat natyrisht se do ta kenë koston e vet financiare, tha ministri.

Në vazhdim ai potencoi se kostoja për anëtarësim do të jetë 25 mijë € në vit, ndërsa nuk do të ketë nevojë për mjete financiare shtesë.

Më tutje, ministri Hamza, u fokusua në rregullat proceduarle të anëtarësimit të Doganës së Republikës së Kosovës në Organizatën Botërore të Doganave, pas ratifikimit të Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor, me ç'rast potencoi se instrumenti i ratifikimit duhet të depozitohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Belgjikës, e cila më pas do ta dorëzojë tek Organizata Botërore e Doganave, për procedim të mëtejshëm.

Në fund, ministri Hamza ftoi deputetët për miratim të Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor.

Deputeti **Naser Osmani**, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, tha se ky komision ka shqyrtuar Konventën për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor dhe i kemi rekomanduar Kuvendin për ratifikim.

Ai diskutoi edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, dhe tha se si grup, di ti japim mbështetje ratifikimit të Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor.

Në emër të GP të PDK-së, **Safete Hadergjona** deklaroi se grupi që ajo përfaqëson përkrah themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor.

Në emër të GP të Lëvizjes Vetëvendosje, **Visar Ymeri** deklaroi se grupi që ai përfaqëson përkrah themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor.

Në emër të GP të AAK-së, **Ardian Gjini** deklaroi se grupi që ai përfaqëson do të votojë pro ratifikimit të Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor.

Në emër të Koalicionit Kosova e Re, **Myzejene Selmani** deklaroi se koalicioni që ajo përfaqëson do të votojë pro ratifikimit të Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor.

Në emër të GP SLS, **Sasha Milosavljević** deklaroi se grupi që ai përfaqëson do të votojë pro ratifikimit të Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor.

Në emër të GP “6+”, **Duda Balje** deklaroi se grupi që ajo përfaqëson do të votojë pro ratifikimit të Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor.

Kryetari në vazhdim hodhi në votim Konventën për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 93,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, njëzëri

V E N D O S I

1. Ratifikohet Konventa për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor për anëtarësimin e Doganës së Republikës së Kosovës në Organizatën Botërore të Doganave.
2. Konventa i dërgohet Ministrit të Punëve të Jashtme të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për deponimin e instrumentit të ratifikimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Belgjikës, për procedim të mëtejshëm.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për persona të zhdukur

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për persona të zhdukur.

Ministri **Ibrahim Makolli** tha se nevoja për nxjerrjen e këtij Projektligji është e madhe, duke pasur parasysh faktin se deri më tani nuk kemi pasur infrastrukturë adekuate ligjore për këtë çështje.

Në vazhdim, ministri tha se Projektligji për persona të zhdukur adreson çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të familjarëve të tyre, të cilët u zhdukën gjatë periudhës 1 janar 1998 deri më 31 dhjetor 2000, si pasojë e luftës në Kosovë në vitet 1998-1999, si dhe kompetencat dhe përgjegjësitë që do të ketë Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur.

Në fund, ministri Makolli kërkoi nga deputetët që ta miratojnë, në parim, Projektligjin për persona të zhdukur.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për persona të zhdukur.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, dhe në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Suzana Novobërdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Kurtan Kajtazi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Rita Hajzeraj-Beqaj, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Albana Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Kimete Bajraktari, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostić, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Duda Balje, si dhe deputetët: Teuta Haxhiu, Blerta Deliu-Kodra, Justina Shiroka-Pula, Rexhep Selimi dhe Ismet Beqiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 70,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për persona të zhdukur.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndihmën shtetërore

Kryesuesi, **Sabri Hamiti**, ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Projektligjin për ndihmën shtetërore.

Ministri, **Bedri Hamza**, tha se deri më tani nuk kemi pasur një ligj që do ta rregullonte këtë fushë.

Në vazhdim, ministri theksoi se qëllimi i këtij Projektligji është rregullimi i ndihmës për shpëtim dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve me vështirësi, lirim, uljen dhe diferencimin e taksave, faljen e pagesave të prapambetura dhe të gjobave, faljen e borxheve, garancitë mbi kreditë ose dhënien e tyre me norma interesi më të ulëta, uljen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore, etj.

Më tutje, ministri tha se ky ligj do të zbatohet për të gjithë sektorët e prodhimit dhe shërbimeve të cilat veprojnë në Kosovë, me përjashtim të sektorëve të bujqësisë dhe të peshkimit.

Në fund, ministri Hamza kërkoi nga deputetët që ta miratojnë, në parim, Projektligjin për ndihmën shtetërore.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për ndihmën shtetërore.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Hykmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Rasim Demiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 55 ,
Kundër----- 3,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për ndihmën shtetërore.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nisma legislative

Kryesuesi lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se ajo nuk i plotëson kushtet për procedim sipas Rregullores së Kuvendit, dhe propozoi që shqyrtimi i saj të bëhet në mbledhjen e ardhshme plenare.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për akreditim

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 069 për akreditim.

Raportin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti, Zenun Pajaziti.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Pajaziti, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4 dhe amendamenti nr. 5.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 63,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 069 për akreditim.

Në vazhdim kryesuesi, **Xhavit Haliti**, në lidhje me shqyrtimin e pikës nr. 9 të rendit të ditës - Shqyrtimi i Propozim-kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, për vitin 2012-2014, tha se në mungesë momentale në Kuvend, për shkak të agjendës zyrtare të ministrit të Financave, z. Bedri Hamza, këtë pikë do ta shqyrtojmë më vonë, posa të arrijë ministri në Kuvend.

10. Shqyrtimi i Projekt-Planit hapësinor të Kosovës, për periudhën 2011-2020

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Projekt-Planin hapësinor të Kosovës, për periudhën 2011-2020.

Ministri, **Dardan Gashi**, tha se Projekt-Plani hapësinor i Kosovës, për periudhën 2011-2020, paraqet një dokument të rëndësishëm të sektorit të planifikimit hapësinor, i cili është ndërtuar në bashkëpunim me të gjithë sektorët relevant të Qeverisë së Kosovës. Në vazhdim tha se në hartimin e këtij plani kanë marrë pjesë ekspertë të fushës nga institucione të ndryshme shkencore, universiteti, organizata të ndryshme joqeveritare, përfaqësues të shoqërisë civile, zyrtarë nga niveli lokal, etj.

Më tutje, ministri tha se me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, është krijuar një bazament krejtësisht i ndryshëm i cili kërkon qasje dhe veprim më të fuqishëm në të gjitha fushat që ndikojnë në zhvillimin e vendit.

Në fund ai kërkoi miratimin e Projekt-Planit hapësinor të Kosovës, për periudhën 2011-2020, nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Projekt-Planit hapësinor të Kosovës, për periudhën 2011-2020.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Nait Hasani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Niazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sali Morina, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Sevdije Lama, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Milosavljeviç, dhe deputetët: Hydajet Hyseni, Lutfi Haziri dhe ministri Dardan Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Projekt-Planit hapësinor të Kosovës, për periudhën 2011-2020.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	48,
Kundër-----	30,
Abstenime-----	1.

Kryesuesi, konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Planin hapësinor të Kosovës, për periudhën 2011-2020.

11. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, për vitin 2010

Deputeti **Zenun Pajaziti**, në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, për vitin 2010, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha- Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të

Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, ndërsa në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, dhe deputetët: Hashim Deshishku, Arben Gashi dhe Muhamet Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 22,
Kundër----- 32,
Abstenime----- 11.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, nuk miratoi Raportin vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, për vitin 2010.

9. Shqyrtimi i Propozim-kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, për vitin 2012-2014

Kryesuesi, **Xhavit Haliti**, ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Propozim-kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, për vitin 2012 – 2014.

Ministri **Bedri Hamza** tha se Propozim-korniza afatmesme e shpenzimeve është një dokument i cili përbën një detyrimi ligjor, bazuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësiwe Financiare, por njëkohësisht është edhe një përkushtim i yni ndaj politikëbërjes.

Në vazhdim tha se ky planifikimi afatmesëm i shpenzimeve publike, është një proces i vazhdueshëm, i cili në thelb paraqet një ndërlidhje në mes të formulimit të politikave dhe planifikimit vjetor të buxhetit.

Më tutje, ministri Hamza theksoi se Qeveria e Kosovës gjatë viteve 2007 – 2014 ka fuqizuar rolin e KASH-it si dokument bazë planifikues duke ndërlidhur hartimin e buxhetit vjetor për vitet përkatëse, me kornizën makroekonomike. Ky dokument rifreskohet në çdo vit, për të reflektuar ndryshimet në supozimet kryesore si dhe ndryshimet në mjedisin makroekonomik.

Ministri Hamza më pas u fokusua në parametrat kryesorë që dalin nga Propozim-korniza Afatmesme e Shpenzimeve, për vitin 2012 – 2014.

Në fund ai kërkoi miratimin e Propozim-kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, për vitin 2012 – 2014.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Propozim-kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, për vitin 2012 – 2014.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim-kornizë, dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi.

Më pas fjalën e mori, deputeti **Ismet Beqiri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, i cili propozoi që debati për këtë pikë dhe shqyrtimi i pikave të mbetura të rendit të ditës, të vazhdohet me dt. 17 qershor 2011.

Lidhur me propozimin e z. Ismet Beqiri, kryesuesi kërkoi prononcimin e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Pas prononcimit të tyre, kryesuesi, hodhi në votim propozimin për vazhdimin e mbledhjes plenare me dt. 17 qershor 2011.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin për vazhdimin e mbledhjes plenare me dt. 17 qershor 2011, në ora 11:00.

Kryesuesi e përfundoi mbledhjen e sotme në ora 17:00.

17 qershor 2011, e premte ora 11:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare të filluar me 16 qershor 2011

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, me pikën e rendit të ditës nr. 9 - **Shqyrtimi i Propozim-kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, për vitin 2012-2014.**

Grupi Parlamentar i PDK-së qëndrimin e vet për këtë pikë të rendit të ditës e kishte paraqitur në mbledhjen e djeshme.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Propozim-kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, për vitin 2012-2014 dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Hykmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Muhamet Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Goran Marinković, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Fikrim Damka, ministri Bedri Hamza, dhe deputetët: Visar Ymeri, Ardian Gjini, Hykmete Bajrami, Blerim Shala, Shaip Muja, Aurora Bakalli, Haki Demolli, Afrim Kasolli, Bekim Haxhiu, Sali Morina, Arben Gashi, Justina Shiroka –Pula dhe Liburn Aliu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi **Xhavit Haliti**, konstatoi se me kaq debati për këtë pikë të rendit të ditës përfundoi.

12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, për vitin 2010

Deputeti **Zenun Pajaziti**, në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, për vitin 2010, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjonaj, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Ali Sadriu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Alma Lama, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Goran Marinkoviç, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 40,
Kundër----- 16,
Abstenime----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, për vitin 2010.

13. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Safete Hadergjonaj**, tha se si komision kemi shqyrtuar Propozimin e Komisionit për Përzgjedhjen e anëtarit dhe kryesuesit të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe i kemi rekomanduar Kuvendit miratimin e këtij propozimi.

Pasi nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për fjalë, **kryetari** hodhi në votim miratimin e Propozim-vendimit për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Ymer HAVOLLI, emërohet kryesues i Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, me mandat deri më 30 prill 2012.
2. Ejup QERIMI, emërohet anëtar i Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, me mandat tre vjeçar.

14. Emërimi i një anëtari të Komisionit Shqyrtues në Zyrën e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina

Në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, **Nait Hasani**, tha se si komision kemi shqyrtuar kërkesën e Zyrës së Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për emërimin e një anëtari të Komisionit Shqyrtues në Zyrën e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, dhe Kuvendit i kemi rekomanduar për miratim.

Pasi nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për fjalë, **kryetari** hodhi në votim emërimin e z. Ylber Aliu, anëtar të Komisionit Shqyrtues në Zyrën e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 43,
Kundër----- 12,
Abstenime----- 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Ylber ALIU emërohet anëtar dhe njëherit kryesues i Komisionit Shqyrtues në Zyrën e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 16:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për çështje plenare dhe procedurale